

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 177 Rep  
Nr. 71 Kol



MARREVESHJE

**PER TRANSFERIMIN E KUOTAVE TE KAPITALIT TE  
SHOQERISE "UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA" SHPK**

Sot ne Tirane me date 27.02.2003, perpara meje noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

**SHITESI:** **Z. Genc Ruli**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 11/04/1958, mbajtes i pasaportes nr. 0011318, banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Dhe

**BLERESI:** **Z. Gramoz Pashko**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 11/02/1955 mbajtes i pasaportes nr. 0013940, banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

**MEQENESE**

- a) Shitesi, zoterues i 75 kuotave, me vlere nominale 10.000 secila, te kapitalit te Shoqerise "University of New York, Tirana" Shpk., qe perfaqesojne 25 % te kapitalit te shoqerise, deshiron t'i shese keto kuota;
- b) Bleresi deshiron te bleje 75 kuota, qe perfaqesojne 25% te pjeseve te kapitalit te Shoqerise "University of New York, Tirana" Shpk;
- c) Kuotat e kapitalit shiten (transferohen) me vleren e tyre nominale per nje shume te pergjitheshme prej 750.000 lekesh.

Palet bien dakort per sa me poshte vijon:

## 1. Objekti i marreveshjes

- 1.1 Sipas kushteve te parashikuara ne kete marreveshje, Shitesi bie dakord te transferoje tek Bleresi dhe ky i fundit bie dakort te bleje 75 kuota, qe perfaqesojne 25% te pjeseve te kapitalit te shoqerise "University of New York, Tirana" Shpk te zoteruara nga Shitesi ne kete shoqeri;
- 1.2 Shitesi Z. Genc Ruli zoterues i 75 kuotave, qe perfaqesojne 25 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise "University of New York, Tirana" Shpk. i shet (transferon) Bleresit Z. Gramoz Pashko keto kuota qe ai zoteron ne kete shoqeri kundrejt çmimit prej 750.000 lekesh;
- 1.3 Bleresi, Z. Gramoz Pashko, deklaron se pranon te bleje pjeset e kapitalit te shoqerise "University of New York, Tirana" Sh.p.k. te zoteruara nga Z. Genc Ruli

## 2. Çmimi i shitjes

- 2.1 Pjeset e mesiperme te kapitalit shiten (transferohen) kundrejt vleres se tyre nominale prej 750.000 lekesh, vlere per te cilen Bleresi nuk ka asnje pretendim. Shitesi gjithashtu nuk ka asnje pretendim mbi kete vlere.
- 2.2 Çmimi i mesiperme i shitjes do t'i paguhet Shitesit ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate.

## 3. Garancite

- 3.1 Shitesi garaton se pjeset e kapitalit qe i shet (transferon) Bleresit nepermjet kesaj marreveshje jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjetër ligjor i te treteve mbi to.
- 3.2 Bleresi i garanton Shitesit se pranon dispozitat e parashikuara ne statutin e shoqerise "University of New York, Tirana" Shpk dhe garanton respektimin e plote te tyre.

## 4. Te ndryshme


Ne momentin qe Shitesit arketon çmimin e siperpermendur, ai humbet çdo te drejte pronesie, mbi keto kuota, si dhe çdo te drejter tjetër qe rrjedh nga zoterimi i pjeseve te kapitalit te Shoqerise dhe Bleresi behet i vetemi pronar i ligjshem i pjeseve kapitalit te Shoqerise qe transferohen nepermjet kesaj marreveshje.

## 5. Baza Ligjore

Kjo marreveshje do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 "Per shoqerite tregtare"

Kjo marreveshje hartohet ne 4 (kater) kopje.

Kjo marreveshje pasi u lexua ne prani te noterit u gjet ne perputhje me vullnetin e lire e te



plote te paleve dhe u nenshkrua rregullisht prej tyre ne pranine time dhe une Noteri e  
vertetoj kete marreveshje sipas ligjit.



SHITESI

Z. Genc Ruli

Genc Ruli

BLERESI

Z. Gramoz Pashko

Gramoz Pashko

NOTERI

[Signature]